

VENDIM
Nr. 385, datë 29.6.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 663, DATË 13.10.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘QAZIM TURDIU’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 663, datë 13.10.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej “10 833 624 (dhjetë milionë e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e katër)” lekësh zëvendësohet me “10 826 810” (dhjetë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e tetëqind e dhjetë)” lekësh;
 - b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit, pasuria me nr. 9/216, në nr. rendor 1, zëvendësohet me nr. 9/1029, sipas të dhënave të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Bashkia Tiranë.
 3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKET PËR NJË NDRYSHIM NË VKM-në NR. 663, DATE 13.10.2022, “NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-VJEÇARE ‘QAZIM TURDIU’”

Nr.	Pronari			Zona kad.	Numri i pasurisë	Sip. totale	Lloji i pas.	Sipërfaqja e shpronësuar	Çmimi lekë/m²	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Sinan Qazim Boka Hajredin Qazim Boka Menduhie Hush Boka Saimir Rexhep Boka Skënder Qazim Boka Merita Rexhep Boka			8330	9/1029	317.8	Truall	317.8	34,068	10,826,810	Konfirmuar nga ASHK-ja
Vlera										10,826,810	

Për tokën “truall”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

